

URDHËR
Nr.5123/3, datë 24.8.2011

PËR HEQJEN E LEJES SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 pika 1 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, nenit 6 germa “b” të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit z.Halil Ukë Sinani, anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, pasi ka mbushur moshën 65 vjeç.
2. Ngritjen e komisionit të dorëzimit të arkivit të përbërë nga 5 anëtarë:
 - a) Z.Arlind Arapi, përgjegjës i sektorit të inspektimit për zbatimin e drejtësisë.
 - b) Znj.Aleksandra Tasi, specialiste në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.
 - c) Znj.Mirela Llaperi, arkiviste në zyrën e mbajtjes së regjistrit të noterëve.
 - d) Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Tiranë.
 - e) Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.
- 3.Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal, në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Tiranë. Arkivi do t’i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 3-mujor, një noteri publik të Dhomës së Noterisë Tiranë që plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivës dhe që kryen një shërbim sa më të shpejtë e cilësor të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.
4. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterit z. Halil Ukë Sinani, nga komisioni i caktuar në pikën 2 të këtij urdhri.
5. Urdhri t’i njoftohet menjëherë ministrive, Dhomës Kombëtare të Noterisë, gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.
6. Ngarkohet sektori i inspektimit për zbatimin e drejtësisë dhe zyra e mbajtjes së regjistrit të noterëve të marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi